



VENDIM

Nr. 27 Datë 02.04.2010

PËR

**LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “ALPIQ ENERGY ALBANIA”
SH.P.K NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TE ENERGJISE
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9, dhe nenit 13, pika 1, germa d, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, neneve 5, 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 02.04.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k, për liçensim në aktivitetin e tregtimit të Energjisë Elektrike,

Dhe Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- o Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni finciar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Liçensimin e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k në aktivitetin e tregtimit të Energjisë Elektrike për një afat 5 vjeçar.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



-
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s
Bujar Nepravishta

Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”10
963
Tirane
69 590
E-mail erealb@ere.gov.al

Tel/Fax +355 42 22

Tel +355 42

www.ere.gov.al